

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegj, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit [“N...”], me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson [J.O] avokat nga Prishtina, kundër të paditurës [“K...”], me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [F.H] për shkak të anulimit të faturës – Rikthimi i humbjeve, në shumën e përgjithshme prej 6.844.69€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.586/18 të datës, 27.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë.16.09.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e paditësit [“N...”], me seli në Prishtinë, ndërsa **PRISHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.586/18, i datës, 27.05.2019 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në shqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë IV.EK.C.nr.586/18 të datës, 27.05.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike në pikën I të dispozitivit ka ndërprere procedurën në këtë çështje kontestimore me IV.EK.C.nr.586/18, deri sa përfundon procedura penale në çështjen sipas kallëzimit penal Nr. ..., dt.01.11.2018, e cila është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm si çështje paraprake. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që procedura do të filloj pas nxjerrjes së aktgjykimit penal në këtë çështje kontestuese.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi [“N...”], me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e paditësit në tërësi si të bazuar, ta anuloj Aktvendimin IV.EK.C.nr.586/18 të datës, 27.05.2019, dhe të vazhdohet procedura kontestimore e ndërprerë me aktvendimin IV.EK.C.nr.586/18 të datës, 27.05.2019.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtojë shkresat e lëndës, pretendimet ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 208 të LPK-së, ka gjetur se:

ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi [“N...”], me seli në Prishtinë me datën 05.11.2018 ka parashtruar padi kundër të paditurës [“K...”], me seli në Prishtinë për kompensimin e demit, anulimin e faturës – rikthimin e humbjeve, duke kërkuar që të aprovet kerkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të vertetohet se pala paditese [“N...”], nuk i ka borxh palës së paditur [“K...”]- [“K1...”] me seli në Prishtinë për faturën e “Rikthimit të humbjeve” nr. ... në shumë prej 6,844.69.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka ndërprerë procedurën në këtë çështje kontestimore deri sa përfundon procedura penale në çështjen sipas kallëzimit penal Nr. ..., dt.01.11.2018, me arsyetimin se vendimi në këtë çështje juridike varet nga fakti se a është kryer vepra penale-vjedhje e energjisë elektrike.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktvendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktvendimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendim dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të atakuar ka theksuar se, *pas shqyrtimit të propozimit të paditurit për ndërprerjen e procedurës dhe provave të lëndës erdhi në përfundim se propozimi është i bazuar*, por nuk ka përmendur se cilat janë këto prova mbi bazën e të cilës ka ardhur deri të konstatimi se propozimi është i bazuar.

Në rastin konkret kontesti zhvillohet për anulimin e faturës respektivisht kontestimin e shumës së faturuar nga e paditura me pretendim se nuk është krijuar detyrimi i paditësit për atë faturë. Raporti detyrimor përbën raport juridiko-civil i cili duhet të zgjidhet në procedurë kontestimore andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate çështja penale nuk përbën çështje paraprake sepse pavarësisht epilogut në procedurë penale lartësia e detyrimit duhet të përcaktohet në procedurë civile. Ngritja e kallëzimit penal nuk nënkupton që domosdoshmerisht do të fillojë edhe procedura penale, ajo përbën veprim të palës i cili edhe mund të keqpërdoret për arsyetimin e veprimit të vet. Për më tepër vendosja në këtë çështje juridike mund të përbëjë çështje paraprake ne procedurë penale dhe vendimi në këtë procedurë mund të shërbejë si bazë për përcaktimin e përgjegjësisë penale.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitoj të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetojë faktet relevante, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme, ashtu që pastaj sipas vlerësimit të gjithanshëm të vendosë drejtë dhe sipas Ligjit.

Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të dispozitave 195, 208 dhe 209 par.1.nën par(d) të LPK-së , u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ae.nr.247/2019,dt. 16.09.2019

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tutuli, d.y.

